


# KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale



## INFORMIM DHE PRIVATËSI

## Përmbajtja

Editorial	faqja	3
“Të rinjtë dhe privatësia” - konkurs për kremtimin e 28 Janarit 2020, Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale		4
28 Shtator 2020, Dita e të Drejtës për Informim		5
Deklaratë e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)		5
Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në kuadër të masave ndaj pandemisë COVID-19		6
Sesioni i Mbyllur Virtual i Asamblesë Globale të Privatësisë		7
Dy udhëzime të reja për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale		8
Takimi i 40-të Plenar i Komitetit të Konventës 108+ të Këshillit të Evropës		9
Publikohet newsletter-it “E drejta për informim”		9
Transparenca proaktive, monitorim i njësive të vetëqeverisjes vendore		10
Miratoohen modelet e rishikuara të Programit të Transparencës dhe Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve për Autoritetet Publike		11
Kuvendi i Shqipërisë miraton Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për vitin 2019		11
Fushata Kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy onlife”		12
Memorandum Mirëkuptimi mes Autoritetit të Konkurrencës dhe Zyrës së Komisionerit		13
Publikohet Raporti i Konferencës së 41-të Ndërkombëtare - ICDPPC		13
E drejta e informimit, transparencë për mirëqeverisjen		14
E drejta për informim përgjatë periudhës së emergjencës shëndetësore		14
Trajnimi i administratës publike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe transparencën		15
Trajnime online me Universitetet e Vlorës dhe Durrësit		15

### Revista **“Informim Dhe Privatësi”**

Redaksia: Alketa Koja, Redi Skënderaj, Irma Arapi, Erald Mullaraj, Elinda Sulejmani.

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## **Nr. 9 & 10 , Dhjetor 2020**

Print: Quantic

### *Të nderuar lexues.*

Në përfundim të këtij viti të vështirë dhe sfidues, Zyra e Komisionerit dëshiron të ndajë me ju, lexuesit e revistës “Informim Dhe Privatësi”, një bilanc të veprimit të saj 12-mujore.

Përhapja e pandemisë COVID-19 detyroi përshtatjen me një realitet krejtësisht tjetër, duke ridimensionuar kudo në botë marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore. Edhe Zyra e Komisionerit programoi resurset e saj për t’iu përshtatur sa dhe si duhet efekteve të kësaj situatë në përmbushje të plotë të detyrave funksionale. Vlen të theksohet fakti, se institucione homologe në disa vende evropiane, madje, e pezulluan tërësisht veprimtarinë e tyre, si në Spanjë, Skoci, etj. Kjo nuk ndodhi me Zyrën e Komisionerit dhe statistikat e vitit 2020 janë treguesi i kësaj qasje në raport me ushtrimin praktik të të drejtave të qytetarëve, ku 1023 ankesa u administruan për të dy fushat e veprimtarisë.

Projekti i Binjakëzimit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me acquis të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave” nisi zbatimin në 1 tetor 2020. Synimi i autoritetit dhe partnerëve është që brenda vitit 2021 Shqipëria të ketë kuadrin e ri rregullator të mbrojtjes së të dhënave personale, të përafruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë, e kombinuar kjo edhe me ratifikimin e Konventës 108+ të Këshillit të Evropës.

Paralelisht, po plotësohet kuadri legjislativ për të drejtën e informimit me miratimin, po gjatë këtij vitit, të ndryshimeve në ligjin 119/2014, ratifikimin e Konventës 205/2009 të Këshillit të Evropës, si dhe përafrimin e Direktivës së BE 2019/1024 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Këto hapa, përveçse janë pjesë e procesit të integritetit evropian të vendit, ju garantojnë qytetarëve shqiptarë standarde akoma edhe më moderne në ushtrimin praktik të të drejtave të tyre kushtetuese.

Përmirësimi dhe forcimi i legjislacionit nuk mund të kuptohen pa një institucion me nëpunës të trajnuar, motivuar dhe aktiv. Mbikëqyrja e plotë ligjore kërkon dhe orienton njohuri nga fusha të ndryshme, rrjedhimisht, vendosjen e urave të reja të bashkëpunimit si në sferën publike ashtu edhe në atë private të shoqërisë. Në këtë mënyrë, nga shkëmbimi i eksperiencës do të rritet eficienta në veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, për një performancë më dinamike dhe zgjidhje praktike të problemeve të qytetarëve.

## **“Të rinjtë dhe privatësia” konkurs për krenimin e 28 Janarit 2020, Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale**



Në Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale TIK

“Hermann Gmeiner”, organizuan konkursin me temë “Të rinjtë dhe privatësia”. Aktiviteti me këtë rast u mbajt në “Qendrën e Inovacionit Protik”.

10 grupe nxënësish të viteve të 3-ta dhe 4-ta të kësaj shkolle prezantuan projekt-aplikacione, ku “politikat e privatësisë” ishin elementi kryesor i vlerësimit nga një juri profesionale. Për përgatitjen e këtyre punimeve mësimore Zyra e Komisionerit dhe stafi i shkollës realizuan një cikël trajnues gjatë muajit janar 2020, për njohjen e parimeve kryesore rregullatore të garantimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.




Aplikacioni “StudentGuard”, punim i grupit të nxënësve Klara Rapo, Josif Çarka, Kledion Nito dhe Sindis Kote, u shpall fitues. Ky projekt është një sistem monitorimi mbi frekuentimin e mësimit, për të vënë në dijeni prindin. Aplikacionet e tjera të prezantuara në konkurs përfshijnë disa fusha, si ajo e menaxhimit të financave

personale apo të biznesit; menaxhimin e të dhënave shëndetësore apo respektimin e dietave ushqimore; lundrimin e sigurt në internet; blerjeve online; kontrollin e postës elektronike; targimin e automjeteve apo parkimin e tyre.

Në ceremoninë e mbajtur për shpalljen e fituesve ishin të ftuar nderi Zëvendëskryetarja e Kuvendit znj. Vasilika Hysi; Ambasadori i Austrisë z. Christian Steiner; zv/kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës, z. Olsi Dekovi; Përfaqësuesi i Delegacionit të BE, z. Aurelien Juliard; përfaqësues nga institucione shtetërore, etj. Autoritetet kombëtare të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, më 28 janar zhvillojnë aktivitete të ndryshme me karakter ndërgjegjësues për qytetarët. Në botë, kjo ditë njihet si Dita e Privatësisë (Privacy Day).








## 28 Shtator 2020, Dita e të Drejtës për Informim

Zyra e Komisionerit mbajti video-projeksion në sheshin “Nënë Tereza” me rastin e 28 Shtatorit - Ditës së të Drejtës për Informim. Aktiviteti u mbajt në kuadër të iniciativave ndërgjegjësuese për qytetarët për ushtrimin proaktiv të të drejtës për t’u njohur me

informacionin me karakter publik, nëpërmjet zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Transparenca dhe llogaridhënia e Autoriteteve Publike është garanci për mirëqeverisjen dhe funksionimin e një shoqërie të zhvilluar demokratike.

Dita e të Drejtës për Informim u vendos në përfundim të Konferencës “Për lirinë e informimit”, e zhvilluar në Sofje të Bullgarisë, në 26-28 shtator 2002, me pjesëmarrjen edhe të Shqipërisë.



### Dita e të Drejtës për Informim, deklaratë e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit

Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtës për Informim, Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioners–ICIC) njoftoi bashkëpunimin me UNESCO (Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën) dhe organizma të tjerë ndërkombëtar për promovimin e kësaj të drejte themelore të njeriut.

Zyra e Komisionerit si anëtare e akredituar e kësaj organizate (ICIC) e përshëndet këtë bashkëpunim dhe shpreh bindjen, se kjo iniciativë është modeli më i mirë për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien e Autoriteteve Publike shqiptare.

*“Komisionerët e Informimit luajnë rol kyç në vënien e Autoriteteve Publike para përgjegjësish, që këto të fundit të garantojnë regjistrimin dhe menaxhimin në mënyrën e duhur të informacionit, përpunimin e saktë të tij dhe respektimin e aksesit në informacion, publikimin në mënyrë proaktive dhe detyrimet e tjera ligjore, sidomos në një situatë emergjence publike” – vlerësohet në këtë deklaratë.*



## Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në kuadër të masave ndaj pandemisë COVID-19



Zyra e Komisionerit në përmbushje të detyrimeve të parashikuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, për t'iu ardhur në ndihmë qytetarëve por edhe kontrolluesve publik apo privat të sektorit në përballimin e pasojave të pandemisë globale COVID-19, publikoi në periudhën mars-maj 2020 tre udhëzues për këtë qëllim:

*i) Udhëzues për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19;*

*ii) Udhëzues për përpunimin e të dhënave personale në sektorë specifikë në kuadër të masave kundër COVID-19;*

*iii) Udhëzues për përpunimin e të dhënave personale sipas Protokolleve të Masave Higjeno-Sanitare COVID-19.*



Udhëzuesit i konsultoni në lidhjen: <https://www.idp.al/udhezime-ne-kuader-te-covid-19/>

Gjatë gjithë vitit 2020 Zyra e Komisionerit ka monitoruar aktivisht masat e marra nga institucionet/ subjektet përgjegjëse, duke u ofruar ndihmën dhe ekspertizën e nevojshme kontrolluesve publik e privat në sektorin e shëndetësisë për përmbushjen e plotë të detyrimeve ligjore. Zyra e Komisionerit shpreh vlerësimin për përpjekjet profesionale dhe njerëzore dhe angazhimin e të gjithë personelit shëndetësor për të parandaluar përshkallëzimin dhe pasojat e rënda të COVID-19. Nga ana tjetër, autoritetet përgjegjëse krahas ushtrimit të veprimtarisë së tyre në këtë drejtim kanë detyrimin për të parandaluar përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të qytetarëve të infektuar nga virusi SARS-COV-2, veprim i cili sjell pasoja të rënda për jetën private dhe dinjitetin e tyre. Në respekt të plotë të lirisë së shprehjes, si një tjetër liri dhe e drejtë vetjake, shprehim konsideratën për vëmendjen dhe mbulimin e përshtatshëm që organet e medias (të shkruara, audiovizive, online) i kanë kushtuar informimit të publikut në lidhje me situatën e pandemisë. Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit nxit e fton të gjithë spektrin mediatik që të tregojë vetëpërmbytje, proporcionalitet dhe etikë profesionale në shpërndarjen e informacionit që shpie dhe/ose mund të shpjerë në identifikimin konkret të pacientëve COVID-19.

Zyra e Komisionerit u bë pjesë aktive e iniciativës së Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA) për funksionimin e një 'Platforme' për konsultimin e praktikave më të mira ligjore për mbrojtjen e të dhënave në raport me situatën e pandemisë COVID-19. Nëpërmjet një deklarate GPA theksoi se "ne jemi të sigurt se kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale nuk do të ndalojnë shkëmbimin vendimtar të informacionit për të mbështetur përpjekjet për të trajtuar këtë pandemi globale. Parimet universale për mbrojtjen e të dhënave personale në legjislacionin e vendeve tona do të mundësojnë

*përdorimin e të dhënave në interes të publikut, por dhe të ofrojnë mbrojtjet që publiku pret. Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave janë të gatshme për të ndihmuar në lehtësimin e shkëmbimit të shpejtë dhe të sigurt të të dhënave për të luftuar COVID-19".*




Statement by the GPA Executive Committee on the Coronavirus (COVID-19) pandemic



## Sesioni i Mbyllur Virtual i Asamblesë Globale të Privatësisë

Asambleja Globale e Privatësisë (GPA) mbajti punimet e Sesionit të Mbyllur Virtual 2020, në datat 13-15 tetor 2020. Zhvillimi i aktivitetit më të rëndësishëm të fushës në këtë formë u kushtëzua nga situata me pandeminë COVID-19. Më shumë se 200 përfaqësues të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë nga të gjitha kontinentet diskutuan për çështje me ndikim të gjerë në respektimin e të drejtave të qytetarëve, si përdorimi i teknologjive në identifikimin e fytyrës apo inteligjenca artificiale; për mbrojtjen e të dhënave në veprimtarinë humanitare dhe për rolin e organizatës në raport me zhvillimet më të fundit në këtë fushë.



Sesioni i Mbyllur miratoi këto rezoluta, për disa prej të cilave Autoriteti shqiptar ka dhënë kontributin e tij në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv dhe të Nënkomitetit të Drejtimit Strategjik të Asamblesë:

- Rezoluta mbi teknologjinë e njohjes së fytyrës (Zyra e Komisionerit është bashkë-propozuese);
- Rezoluta mbi rolin e mbrojtjes së të dhënave personale në ndihmën ndërkombëtare për zhvillim, ndihma ndërkombëtare humanitare dhe menaxhimi i krizës (Zyra e Komisionerit është bashkë-propozuese);
- Rezoluta mbi llogaridhënien në zhvillimin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale;
- Rezoluta mbi deklaratat e përbashkëta për çështjet globale që po lindin (Zyra e Komisionerit është bashkë-propozuese);
- Rezoluta mbi sfidat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave që po lindin në kontekstin e pandemisë COVID-19 (Zyra e Komisionerit është bashkë-propozuese).



Home Assembly & Executive Committee News & Events Members Documents Cooperation

**Data protection and COVID-19 resources**

Data protection authorities across the world stand ready to help facilitate swift and safe data sharing to fight COVID-19, while still providing the protections the public expects.

[VIEW RESOURCES >](#)



Sesioni i Mbyllur diskutoi për veprimtarinë e Task Forcës për mbrojtjen e të dhënave në situatën e pandemisë COVID-19. Në rolin e koordinatorit, kjo strukturë ka shkëmbyer informacion dhe praktikatat më të mira që u janë rekomanduar institucioneve publike dhe sektorit privat për garantimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve. Edhe Zyra e

Komisionerit iu bashkua kësaj nisme, duke publikuar 3 Udhëzues për këtë qëllim. Në ditën e tretë të punimeve të Sesionit të Mbyllur u diskutuan dhe u miratuan dokumente/raporte të tjera të hartuara nga Grupet e posaçme të Punës të GPA. Pjesë e agjendës së punimeve të Sesionit të Mbyllur ishte zhvillimi i zgjedhjeve për anëtarësinë e Komitetit Ekzekutiv, ku u konfirmua për një mandat të dytë znj. Angelene Falk, Komisionere e Australisë. Z. Ulrich Kelber, Komisioner Federal i Gjermanisë u zgjodh rishitazi në vend të z. Raymund Enriquez Liboro, Komisioneri i Filipineve. Asambleja Globale e Privatësisë i shtoi radhët e saj edhe me 4 anëtarë të rinj Autoritetin e Privatësisë së Bermudeve, Avokatin e Popullit të Ishujve Kajman, Komisionerin e Mbrojtjes së të Dhënave të Qendrës Financiare Ndërkombëtare të Dubait dhe Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave të Kantonit të Bernës në Zvicër; ndërsa Organizata e Konsumatorëve Evropianë u pranua me statusin e vëzhguesit.

## Dy udhëzime të reja për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Ministri i Brendshëm, z. Sandër Lleshaj dhe Komisioneri, z. Besnik Dervishi, nënshkruan dy udhëzime të përbashkëta në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Ata janë Udhëzimi nr. 463 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” (Udhëzimi nr.

463/2020) dhe Udhëzimi nr. 464 “Për përpunimin e të dhënave personale nga njësia e informacionit të pasagjerit” (Udhëzimi nr. 464/2020). Këto dokumente garantojnë standarde të larta në përdorimin/shkëmbimin e të dhënave personale të qytetarëve nga kontrollues publik dhe/ose privat dhe njëkohësisht, mbrojtjen e të dhënave në përdorimin e shërbimeve online.

Ministri Lleshaj në fjalën e tij tha: *“Qeveria prej kohësh po punon fort për të rritur numrin e shërbimeve që ofrohen për qytetarët, kryesisht shërbimet online”.*

Komisioneri Dervishi, duke vlerësuar bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme, ndër të tjera theksoi se: *“këto udhëzime përmirësojnë akoma më shumë kuadrin rregullator në funksion të garantimit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, e cila është një e drejtë e parashikuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.*

Udhëzimi nr. 463/2020, përcakton standarde të unifikuara dhe të larta në aksesimin e “Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile” (RKGJC) nga organe/institucione/subjekte të ndryshme publike dhe/ose private. Ky Udhëzim, shfuqizon Udhëzimin nr. 95/2014 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”. Hartimi i këtij udhëzimi të ri u iniciua në kuadër të përshtatjes me zhvillimet dhe zgjerimin e përdorimit të teknologjive të reja në ofrimin e shërbimeve shtetërore online. Nga ana tjetër, është shtuar numri i kërkesave nga institucione të reja, të cilat e kanë të domosdoshme aksesin në RKGJC për përmbushjen e detyrave funksionale, si dhe nga ato që kanë ndryshuar ndër vite emërtesën apo strukturën në referencë të objektit të veprimtarisë që ushtrojnë.

Udhëzimi nr. 464/2020, është hartuar në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, i ndryshuar, i cili përcakton Zyrën e Komisionerit si Autoritetin Kombëtar përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të mbledhjes/përpunimit, shpërndarjes dhe shkëmbimit të të dhënave personale të pasagjerëve. Informacioni Paraprak për Pasagjerin (API-Advanced Passenger Information) dhe Të Dhënat e Regjistrit të Rezervimit të Pasagjerit (PNR-Passanger Name Record) janë dy kategori

specifike informacioni personal që administrohen në një bazë të posaçme të dhënash nga Njësia e Informacionit të Pasagjerit (NIP) pranë Policisë së Shtetit. Udhëzimi ka si qëllim përcaktimin e mënyrës së transmetimit të të dhënave dhe sigurimin e nivelit të përshtatshëm të mbrojtjes të të dhënave personale nga NIP, në ndërveprim me subjektet transportuese/kompanitë ajrore që kanë detyrimin e ofrimit të këtyre të dhënave.





## Takimi i 40-të Plenar i Komitetit të Konventës 108+ të Këshillit të Evropës

Mbledhja e 40-të Plenare e Komitetit të Konventës për Mbrojtjen e Personave nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale (Konventa 108+) të Këshillit të Evropës (T-PD) i zhvilloi punimet e saj virtualisht, në datat 18-20 nëntor 2020.

Zyra e Komisionerit, si anëtare e Komitetit T-PD, depozitoi raportin e përvitshëm të aktiviteteve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale për periudhën 2019-2020. Në 3 ditë të punimeve të Takimit, me pjesëmarrjen e mbi 150 përfaqësuesve të autoriteteve e organizatave anëtare dhe vëzhguese, u diskutua mbi dokumente e raporte të rëndësishme dhe u mbajtën disa prezantime ekspertësh.

Komiteti T-PD miratoi “Udhëzuesin mbi mbrojtjen e të dhënave të fëmijëve në kuadrin arsimor”. Ndërsa, u vendos për aprovimin me procedurë të shkruar në takimet e ardhshme të dokumenteve si: “Profilizimi dhe Konventa 108+, Raport mbi zhvillimet pas miratimit të Rekomandimit (2010)13 mbi Profilizimin”; Raporti mbi “Identitetin digjital”; si dhe Raporti mbi “Përpunimin e të dhënave personale nga dhe për fushata politike: zbatimi i Konventës 108 të modernizuar”. Në këtë mbledhje, u paraqit dhe Raporti nga përfaqësuesi i Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA) për Konferencën e 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, të organizuar nga Zyra e Komisionerit në 21-24 tetor 2019, në Tiranë. Gjithashtu, u zhvilluan edhe zgjedhjet e Byrosë së Komitetit, ku u rikonfirmua edhe për një mandat tjetër znj. Alessandra Pierucci në drejtimin e këtij forumi.

Konventa 108 është miratuar në vitin 1981, ndërsa Komiteti T-PD është përgjegjës për interpretimin e dispozitave dhe për garantimin e zbatimit të saj. Modernizimi i vitit 2018, i njohur ndryshe si Konventa 108+, është nënshkruar deri tani nga 33 shtete dhe është ratifikuar nga 9 prej tyre. Shqipëria është në procesin e ratifikimit të kësaj Konvente të rëndësishme.

### Publikohet newsletter-it “E drejta për informim”

Kjo formë komunikimi ka për qëllim të nxisë njohjen e publikut me zbatimin e legjislacionit në fushën e të drejtës për informim. Transparenca dhe llogaridhënia e Autoriteteve Publike (AP) është shumë e rëndësishme për funksionimin e një shoqëri demokratike. Kjo mundësohet nga ndërveprimi mes qytetarëve,



organizatave të shoqërisë civile apo medias me çdo institucion të administratës publike dhe veçanërisht, me koordinatoren për të drejtën e informimit. Publikimi i newsletter-it do të jetë i përmuajshëm, duke bërë të njohur veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Zyrës së Komisionerit në lidhje me ankesat e paraqitura, raportet mbi transparencën e AP, si dhe të rejat më të fundit nga kjo fushë.

## Transparenca proaktive, monitorim i njësive të vetëqeverisjes vendore

Zyra e Komisionerit monitoroi Programet e Transparencës të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2020.

Në një seancë dëgjimore, të realizuar online, u trajtuan gjetjet e këtij monitorimi me pjesëmarrjen e kryetarëve

apo përfaqësuesve të tyre, si dhe koordinatorëve nga 61 bashkitë e vendit. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin Model të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore, i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga 61 bashkitë e vendit prej janarit 2019. Transparenca proaktive nëpërmjet publikimit të informacioneve në Programin e Transparencës kërkon një impenjim të Autoriteteve Publike për ta përditësuar dhe plotësuar atë me informacion në mënyrë të vazhdueshme.

*“Ftoj njësitë e vetëqeverisjes vendore që pasi të njihen me këtë Raport Monitorimi të marrin masat e domosdoshme për përmbushjen e mangësive të evidentuara në të” – vlerësoi Komisioneri, z. Besnik Dervishi, në fjalën e tij.*

Raporti i monitorimit i Zyrës së Komisionerit është bazuar në 4 tregues vlerësimi: publikimi i Programit të Transparencës; publikimi i “Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve” (përditësimi i vitit 2020); të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit, si dhe instalimi i “Regjistrin elektronik për kërkesat dhe përgjigjet për të drejtën e informimit” (REKPD). Plotësimi dhe përditësimi i informacionit me karakter publik në Programet e Transparencës, përveçse një detyrim ligjor, është mjaft i rëndësishëm për bashkitë për natyrën e veprimtarisë së tyre në raport me shërbimet dhe informimin e qytetarëve.



Në konkluzion të këtij Raporti, Zyra e Komisionerit thekson se në krahasim me vitin 2019 kemi një rënie të transparencës proaktive tek njësitë e vetëqeverisjes vendore në 3 elementët e parë të metodologjisë së zbatuar. Zyra e Komisionerit do të vlerësojë në vijimësi reagimin e çdo njësie të vetëqeverisjes vendore në lidhje me transparencën proaktive dhe përmbushjen e plotë të detyrimeve ligjore.



## Miratohen modelet e rishikuara të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për Autoritetet Publike

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratoi modelin e rishikuar të Programit të Transparencës dhe atë të “Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve” për Autoritetet Publike. Këto akte janë botuar në Fletoren Zyrtare nr. 224, datë 22.12.2020. Modelet e rishikuara të Programit të Transparencës dhe “Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve” janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha Autoritetet Publike brenda datës 31 mars 2021. Këto dokumente u përditësuan në përputhje me parashikimet e neneve 4/c, 5, 6 dhe 8 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Këto formate të reja përmirësojnë standardet e transparencën proaktive të Autoriteteve Publike.



### Kuvendi i Shqipërisë miraton Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për vitin 2019

Në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë të datës 21 maj 2020, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, prezantoi Raportin Vjetor të veprimtarisë së institucionit për vitin 2019. Sipas procedurës, Kuvendi miratoi dhe Rezolutën “Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe

Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2019”.

Raporti Vjetor u paraqit nga Komisioneri në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit në muajin mars 2020.

Viti 2019 ishte një periudhë intensive pune dhe sfidash, i cili kulmoi me zhvillimin me sukses të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) në Tiranë, në datat 21-24 tetor.





## Fushata Kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy onlife”

Fushata Kombëtare është iniciativa ndërgjegjësuere për përdorimin e sigurt të mjedisit digjital nga fëmijët dhe të rinjtë. Përgjatë periudhës tetor-dhjetor 2020 u zhvilluan 22 takime në shkolla 9-vjeçare në qytetet e Kavajës, Rrogozhinës, Cërrikut, Gramshit, Belshit, Peqinit, Elbasanit, Librazhdit, Laçit, Krujës, Rrëshenit, Lezhës, Shkodrës, Koplikut, Kukësit, Krumës, Burrelit, Klosit, Vorës, Kamzës dhe Durrësit.



Në këto aktivitete, në zbatim të masave/protokolleve shëndetësore për parandalimin e përhapjes së pandemisë globale COVID-19, morën pjesë nxënës të klasave të 6-ta, 7-ta dhe të 8-ta dhe mësues të lëndëve të gjuhës angleze, informatikës apo qytetarisë. Përfaqësuesit e Zyrës e Komisionerit në bashkëbisedim me pjesëmarrësit ndanë informacione dhe këshilla praktike për mbrojtjen e privatësisë, sidomos në përdorimin e rrjeteve sociale. Loja “Happy Onlife” ka si qëllim që të nxisë të rinjtë, që nga i menduari kritik, të mësojnë për përdorimin e sigurt të të dhënave personale në mjedisin digjital. Njëkohësisht, synohet të rritet dhe ndërgjegjësimi i mësuesve e prindërve për të ndihmuar adoleshentët në parandalimin/minimizimin e fenomeneve negative si bullizmi, përdorimi i identitetit të tjerëve, si dhe kontaktet e padëshiruara. Në këto takime u shpërndanë botime të Zyrës së Komisionerit, si “Kudri i aftësimin të mësuesve të shkollave 9-vjeçare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve” dhe fletëpalosje të ndryshme.

Sot në botë, ashtu si edhe në Shqipëri, rezulton se të rinjtë janë më shumë përdorues të teknologjive digjitale në krahasim me grup-moshat e tjera, rrjedhimisht dhe më të ekspozuar ndaj rreziqeve në internet. Zyra e Komisionerit vlerëson dhe falënderon për bashkëpunimin e koordinim në realizimin e kësaj Fushate Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe strukturat e saj të varësisë, si dhe partnerin “Raiffeisen Invest”. Ky projekt u bë i

mundur pas pilotimit të lojës “Happy onlife” në 6 shkolla 9-vjeçare të Tiranës në janarin e 2019, ndërsa, kjo iniciativë do të vijojë në fazën e dytë edhe në qytete të tjera të vendit. Loja “Happy Onlife” është përgatitur nga Qendra e Bashkuar Kërkimore e Bashkimit Evropian (Joint Research Centre), në vitin 2015.



## Memorandum Mirëkuptimi mes Autoritetit të Konkurrencës dhe Zyrës së Komisionerit

Institucionet do të bashkërendojnë punën në funksion të objektit të veprimitarisë respektive institucionale, për të nxitur transparencën dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë në treg, mbrojtjen e të dhënave

personale, si një model për shoqërinë në garantimin dhe zbatimin e të drejtave themelore të njeriut. Ky dokument i angazhon këto Autoritete në një sërë aspektesh, ku ndër më kryesoret përfshihen: dhënia e mendimeve/sugjerimeve në hartimin e akteve që prekin objektin e veprimit të palës tjetër; shkëmbimin e ekspertizës dhe praktikave më të mira; ndërlidhjen mes konkurrencës, konsumatorit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe identifikimin e sfidave në ndërtimin e transparencës, besimit dhe llogaridhënies; garantimin e standardeve më të larta gjatë procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave me autoritetet ndërkombëtare apo simotra; si edhe nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjellë. Nënshkrimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është një tjetër instrument për institucionet e pavarura në fjalë për mbikëqyrje më të integruar të legjislacionit për garantimin e të drejtave të qytetarëve.



## Publikohet Raporti i Konferencës së 41- të Ndërkombëtare - ICDPPC

Zyra e Komisionerit publikoi, në shtator 2020, Raportin e Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë – 41-st International Conference of Data Protection

and Privacy Commissioners – ICDPPC. Tematika e aktivitetit më të rëndësishëm të fushës, që u zhvillua në Tiranë më 21-24 tetor 2019, ishte “Konvergjencia dhe Ndërlidhja, Rritja e Standardeve Globale të Mbrojtjes së të Dhënave në Epokën Digjitale – Convergence and Connectivity, Raising Global Data Protection Standards in the Digital Age”. Tashmë ICDPPC është emërtuar Asambleja Globale e Privatësisë (Global Privacy Assembly). Raporti është hartuar nga Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Sekretariatit e GPA dhe është miratuar nga Komiteti Ekzekutiv, organi më i lartë drejtues i organizatës.

Raportin e konsultoni të plotë në lidhjen: <https://privacyconference2019.info/icdppc-2019-report-now-available/>





## E drejta e informimit, transparencë për mirëqeverisjen

Në mjediset e institucionit u zhvillua një takim me pjesëmarrjen e koordinatorëve të Autoriteteve Publike qendrore, Kryeministrisë dhe të ministrive. Gjatë këtij bashkëbisedimi u diskutuan çështje rreth transparencës proaktive, zbatimin e rekomandimeve të Zyrës së Komisionerit për përditësimin

e Programit të Transparencës së këtyre Autoriteteve Publike; përdorimin e “Regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (REKPDII); si dhe për ankesat në proces dhe problematikat e hasura gjatë trajtimit të tyre. Roli i koordinatorit ishte një tjetër temë e diskutuar në takim, ku Zyra e Komisionerit do të vijojë asistencën dhe mbështetjen në forcimin e pozicionit të tyre në strukturat e Autoriteteve Publike. Zbatimi i ligjit “Për të drejtën e informimit”, duke marrë në konsideratë situatën me pandeminë COVID-19, për rritjen e transparencës dhe llogaridhënien e Autoriteteve Publike, merr një rëndësi akoma edhe më të madhe në informimin e saktë të gjithë qytetarëve.

## E drejta për informim përgjatë periudhës së emergjencës shëndetësore

Nëpërmjet platformave të komunikimit online, Zyra e Komisionerit zhvilloi disa takime informuese e ndërgjegjësuese me temë “E drejta për informim përgjatë periudhës së emergjencës shëndetësore”.



Në to morën pjesë koordinatorët e të drejtës për informim të institucioneve të pavarura, të ministrive, si dhe të organeve të vetëqeverisjes vendore. Zyra e Komisionerit vlerëson përpjekjet e përbashkëta për përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit. Një vëmendje të shtuar në këtë situatë, Autoritetet Publike duhet t'i kushtojnë përditësimin të vazhdueshëm të Programit të Transparencës dhe “Regjistrit të kërkesave

dhe përgjigjeve”, instrumente të rëndësishme në funksion të transparencës dhe llogaridhënies së administratës publike. Zyra e Komisionerit për këtë qëllim përgatiti dhe një poster elektronik ndërgjegjësuës, duke i nxitur Autoritetet Publike për ta publikuar atë në faqet zyrtare në internet dhe në ambiente ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.


  
**Mbajmë distancë - Publikojmë informacion**  
**TRANSPARENCË ME DISTANCË**

- 01 Ruani dhe dokumentoni në mënyrë digjitale të gjithë veprimtarinë e autoritetit publik.
- 02 Konsultoni kategoritë e informacionit që duhet të jenë publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 119/2014.
- 03 Publikoni në faqen zyrtare informacionin e ri të krijuar sipas kategorive përkatëse.
- 04 Informacioni i publikuar duhet të jetë në format lehtësisht të aksesueshëm.
- 05 Për çdo informacion më të detajuar mund të kontaktoni me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dënave Personale.



## Trajnimi i administratës publike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe transparencën

Me temën “Mbrojtja e të dhënave personale” u zhvillua trajnimi online me pjesëmarrjen e një grupi nëpunësish civilë të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND) nga institucione të ndryshme, organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).



Lektore e këtij moduli ishte znj. Pjerina Gaxha, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Zyrën e Komisionerit. Trajnimi kishte në fokus njohjen me kuadrin ligjor të kësaj fushe, parimet kryesore të përpunimit të të dhënave personale, të drejtat e subjektit të të dhënave (individit) si informimi, aksesimi, korrigjimi, etj., apo detyrimet e kontrolluesit për një proces të sigurt. Njëkohësisht, të pranishmit u njohën edhe me risitë e legjislacionit ndërkombëtar në këtë fushë, kryesisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR) në Bashkimin Evropian.


Në këtë trajnim pati një ndërhyrje edhe nga Komisioneri Dervishi. Në fjalën e tij, ai nënvizoi rëndësinë për marrjen e të gjitha masave për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve nga kontrollues publik dhe privat, veçanërisht, në situatën e fundit të krijuar prej pandemisë së Covid-19. Nga ana tjetër, ai theksoi dhe vlerësoi domosdoshmërinë e trajtimit në mënyrë proporcionale të privatësisë me transparencën, si një ndër parimet kryesore të mirëqeverisjes e llogaridhënies të Autoriteteve Publike.

## Trajnime online me Universitetet e Vlorës dhe Durrësit

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali” dhe atë të Durrësit “Aleksandër Moisiu” zhvilloi trajnimet me temë “E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale”. Të dy këto aktivitetet u mbajtën nëpërmjet platformave të komunikimit online. Në trajnime u fol për legjislacionin e të dy fushave të veprimtarisë së institucionit, rolin dhe funksionet e Zyrës së Komisionerit, si dhe u trajtuan me raste praktike apo u shpjeguan me shembuj pyetjet/situatat e ngritura nga të pranishmit.

Lektore në këtë aktivitet ishin znj. Elona Hoxhaj – Drejtor i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit dhe znj. Pjerina Gaxha – Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në trajnim morën pjesë mbi 100 studentë nga profile dhe programe të ndryshme mësimore të këtyre universiteteve dhe pjesëtarë të stafit akademik e atij administrativ. Zyra e Komisionerit parashikon të zhvillojë edhe gjatë vitit 2021 aktivitetet të kësaj natyre me Institucione të tjera të Arsimit të Lartë në vend, publike apo private.





KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë

Tel: +355 42237200

Nr. i gjelbër: 08002050

[www.idp.al](http://www.idp.al)

[info@idp.al](mailto:info@idp.al)



© European Union, 2015